

# EPOKA ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5906  
E enjte, 17 tetor 2019  
çmimi 0.40 €

## Arrestime të reja në veri për vrasjen e Ivanoviqit

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

### AKTUALE



**BURIM RAMADANI: MINISTRAT  
DHE ZËVENDËSMINISTRAT  
TË KALOJNË NËPËR VERIFIKIM  
TË SIGURISË** F. 7

**NDËRTIMI I SHITËPIVE PËR  
FAMILJET NË NEVOJË NË  
DRENAS, AFËR PËRFUNDIMIT** F. 10

**TAHIRI: MINISTRIA  
E DREJTËSISË NUK  
KA PRANUAR EKSPERTIZËN  
E RASTIT DEHARI** F. 6

### EKONOMI



**THESARI AMERIKAN PREMTON  
VAZHDIM TË MBËSHTETJES  
PËR KOSOVËN** F. 8

**POSTA LËSHON NË PËRDORIM  
PULLËN '30-VJETORI I GREVËS  
SË MINATORËVE'** F. 9

### SPORT

**LIMANI 'KËRCËNON'  
BALLKANIN: DRITA TË DIELËN  
MERR POZITËN E PARË** F. 18

FLET PËR "EPOKËN E RE", JAKUP KRASNIQI

FAQE 4-5



## KOALICIONI NISMA-AKR-PD DO TË JETË PJESË E KUVENDIT POR, JO SIÇ E KEMI PRITUR

Kryetari i Këshillit Kombëtar të Nismës Socialdemokrate, Jakup Krasniqi, ka thënë se sovrani më 6 tetor e ka kryer detyrën e vet mirë, por ka pasur tentime të blerjeve të votave dhe deformim të rezultatit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e

re", ai ka deklaruar se në procesin zgjedhor administrativisht ka pasur gabime jo të vogla, për të cilat KQZ-ja e ka përgjegjësinë e vet. Krasniqi ka thënë se koalicioni Nisma-AKR-PD do të jetë pjesë e Kuvendit por, jo siç ka pritur. Sipas tij, ky koalicion, siç duket,

nuk është pranuar nga zgjedhësit. Krasniqi ka folur edhe për qeverinë e re, për të cilën ka thënë se do të ketë vështirësi pasi që partitë kanë dallime ideologjike. Ai ka theksuar se qeveria LV-LDK do t'i ketë sfidat të mëdha në disa rrafshë

Sot pritet të përfundojë procesi i numërimit të votave nga diaspora

## Edhe diaspora votoi për Lëvizjen Vetëvendosje

FAQE 3

Lëvizja Vetëvendosje është duke prirë bindshëm në numërimin e rreth 13 500 fletëvotimeve të diasporës të cilat kanë ardhur përmes postës gjatë periudhës së votimit 19 shtator - 5 tetor 2019. Pas saj renditen LDK-ja, PDK-ja, koalicioni AAK-PSD dhe koalicioni Nisma-AKR-PD. Procesi i numërimit të votave me postë është përcjell edhe nga vëzhguesit e partive politike dhe organizatat joqeveritare



**Veseli  
takon  
Apostolovën,  
flasin për  
qëndrimet e  
PDK-së** F. 7

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Curëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666



## Vjosa Osmani takon Palmerin në Uashington



**PRISHINË, 16 TETOR** - Kandidatja e LDK-së për kryeministre në zgjedhjet e fundit të Kosovës, Vjosa Osmani është duke qëndruar për një vizitë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ajo të mërkurën është takuar me zëvendës ndihmës sekretarin amerikan të Shtetit, Matthew Palmer, i cili është po ashtu Përfaqësues Special për Ballkanin Perëndimor. Osmani ka bërë të ditur se në këtë takim me zyrtarin amerikan kanë diskutuar për raportet e Republikës së Kosovës me Shtetet e Bashkuara dhe punët e rëndësishme që na presin përpara. "Sot në Departamentin e Shtetit u prit

nga zëvendës ndihmës Sekretari i Shtetit, Matthew Palmer, i cili është po ashtu Përfaqësues Special për Ballkanin Perëndimor. Diskutuam për raportet e Republikës së Kosovës me Shtetet e Bashkuara dhe punët e rëndësishme që na presin përpara", ka shkruar Osmani në llogarinë e saj personale në Facebook. Matthew Palmer ka treguar kohë më parë se në agjendën e tij si pikë kryesore do të jetë dialogu ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, ndërkohë kërkesë e tij është që Kosova të heqë vendimin për taksën ndaj produkteve me origjinë nga Serbia dhe Bosnjë e

Hercegovina. "Një prej qëllimeve tona kryesore është që t'i japim përkrashje një qeverie në Kosovë e cila është e përkushtuar në dialog, gjë që nënkupton suspendimin e taksës dhe rikthimin në tavolinën e bisedimeve", kishte thënë Palmer. Sipas tij, zgjidhja ideale për dy palët do të jetë njohja reciproke, dhe se SHBA-ja do të luajë rolin e vet prej partneri sapo dy palët t'i kthehen tryezës së bisedimeve. Vjosa Osmani të martën në Shtëpinë e Bardhë, është takuar me drejtorin për Evropë, John Earth, në kuadër të Këshillit për Siguri Kombëtare.

## Negociatat për Shqipërinë, në gjysmën e parë të vitit 2020

Në raportin final të përgatitur pas mbledhjes së ministrave të BE-së, i cili do t'u dorëzohet kryeministrave të BE-së sot (e enjte) thuhet se negociatat për Shqipërinë shtyhen në gjysmën e parë të vitit 2020



**TIRANË, 16 TETOR** - Negociatat për Shqipërinë shtyhen në gjysmën e parë të vitit 2020. Kështu thuhet në raportin final të përgatitur pas mbledhjes së ministrave të BE-së një ditë më parë, raporti i cili do t'u dorëzohet kryeministrave të BE-së sot (e enjte). Ndryshe nga Shqipërisë, dokumenti final kërkon hapjen e negociatave për Maqedoninë e Veriut. Në kuadër të progresit të arritur te reformat dhe kushtet e vendosura njëzëri nga Këshilli në qershor 2018, Këshilli pajtohet me hapjen e negociatave të pranimit jo më vonë se në gjysmën e parë të vitit 2020, dhe fton Komisionin të paraqesë, pa vonesë, një propozim për një kornizë për negociatat në përputhje me konkluzionet e Këshillit Evropian në dhjetor 2006 dhe në përputhje me

paragrafin 3. Për të mbështetur rrjedhën e reformës, parimi i parë themelor duhet të jetë i integruar në procesin e negociatave, duke përfshirë një qasje të përforcuar më tej ndaj sundimit të ligjit. Korniza e bisedimeve do të miratohet nga Këshilli.

"Para konferencës së parë ndërqeveritare, e cila duhet të zhvillohet jo më vonë se në gjysmën e parë të vitit 2020, në varësi të përparimit të arritur, Shqipëria duhet të sigurojë funksionimin e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, dhe të bëjë përparim të mëtejshëm në reformën zgjedhore në përputhje me rekomandimet e OSBE / ODIHR", thuhet në dokumentin final të ministrave të BE-së.

Para se të hapen kapitujt e parë, Shqipëria duhet t'i adresojë

çështjet e mëposhtme: Fillimin e hetimeve ndaj gjykatësve dhe prokurorëve për sjellje kriminale si rezultat i gjetjeve të procesit të vetting-ut. Fillimin e hetimeve në rastet e pretendimeve për mashtrim elektoral. Sigurimin e funksionimit të SPAK. Forcimin e mëtejshëm të historikut të hetimeve, procedimeve dhe dënimeve për-

fundimtare në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, përfshirë këtu edhe nivelet e larta. Miratimin dhe zbatimin e ligjit zgjedhor në përputhje me rekomandimet e OSBE/ODIHR. Zbatimi i çdo vendimi të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me zgjedhjet vendore të 30 qershorit 2019.

Këshilli inkurajon Shqipërinë t'i

vazhdojë përpjekjet për reformat, veçanërisht në fushat themelore për procesin e pranimit në BE. Partitë opozitare duhet të përfshihen sërish në mënyrë konstruktive në institucionet demokratike. Të gjithë aktorët politikë duhet të angazhohen në axhendën e reformave të BE-së dhe të dialogojnë për të kapërcyer polarizimin politik. (k).

## Presidenti Macron thotë se s'ka negociata me Shqipërinë

**PARIS, 16 TETOR** - Kancelarja gjermane, Angela Merkel nuk ka arritur të bindë presidentin francez, Emmanuel Macron, për hapjen e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut.

Në konferencën e përbashkët me gazetarë, Merkel u shpreh: "Kemi disa diferenca sa i përket problematikave që janë shfaqur. Ashtu siç e dini, duhet një vendim

unanim për çeljen e negociatave".

Ndërsa Macroni tha se përshëndet reformat e ndërmarra nga dy shtetet ballkanike, por theksoi gjithashtu se "do t'i përmbahemi deklaratave tona politike sa i përket çështjeve kaq të rëndësishme". Macroni tha se Ballkani është një rajon strategjik për Evropën, por fillimisht duhet të reformohet procedura e pranimit. Ai vuri në dukje

edhe faktin se rinia shqiptare emigron gjithnjë e më shpesh në Bashkimin Evropian.

"Rinia shqiptare vjen më së shumti në BE dhe e shohim më së shumti në Francë. Unë do të ndalesha sërish te rithemelimi i procedurës apo riparja e saj. Po e shpall vizionin tim gjeopolitik në krah të kancelares, por më duhet të shpjegoj edhe këto gjëra të tjera", u shpreh Macroni.





Sot pritet të përfundojë procesi i numërimit të votave nga diaspora

# Edhe diaspora votoi për Lëvizjen Vetëvendosje



## Ahmetaj: Nëse s'përputhen votat e subjekteve dhe kandidatëve mund të ketë rinumërim sërish

Koordinatori i Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve (QNR), Burim Ahmetaj, ka deklaruar se ka përfunduar procesi i rinumërimit të 314 vendvotimeve. "Procesi i rinumërimit të 314 vendvotimeve për të cilat është marrë vendim nga KQZ-ja për rinumërim për shkak të gabimeve në printimin e formularëve të rezultateve ka përfunduar të martën rreth orës 21:40", ka thënë Ahmetaj. Ai ka treguar se rinumërimi ka shkuar normalisht. "Procesi ka rrjedhur normalisht edhe pse kemi pasur të bëjmë me vendvotime që kanë pasur pjesëmarrje të madhe të votuesve në zgjedhje kjo ka marrë kohë 4 orë që të bëhet rinumërimi i një vendvotimi, për këtë arsye procesi ka shkuar më ngadalë sesa e kemi paraparë", ka deklaruar Ahmetaj. I pyetur nëse ka gjasa të bëhet rinumërimi edhe i vendvo-

timeve të tjera, Ahmetaj ka deklaruar se QNR-ja është në përgatitje të raportit për procedimin e formularëve të rezultateve, që do të thotë votat e subjekteve dhe kandidatëve duhet të përputhen. Sipas tij, në rast se ka mospërputhje të votave atëherë do të hetohen dhe KQZ-ja do të marrë vendim që të shkohet në rinumërim. "Ende jemi në përgatitje të procesit të raportit të auditimit i cili rrjedh nga procedimi i formularëve të rezultateve, ku votat e subjekteve dhe kandidatëve duhet të përputhen. Në rast të mospërputhjeve të votave të subjekteve dhe kandidatëve, të gjitha këto raste identifikohen në auditim, hetohen dhe do të përgatitet raporti për KQZ-në dhe në bazë të rekomandimeve të QNR-së, atëherë KQZ-ja mund të marrë vendim lidhur me vendvotimet të cilat mund të shkojnë në rinumërim", ka deklaruar Ahmetaj.

Lëvizja Vetëvendosje është duke prirë bindshëm në numërimin e rreth 13 500 fletëvotimeve të diasporës të cilat kanë ardhur përmes postës gjatë periudhës së votimit 19 shtator - 5 tetor 2019. Pas saj renditen LDK-ja, PDK-ja, koalicioni AAK-PSD dhe koalicioni Nisma-AKR-PD. Procesi i numërimit të votave me postë është përcjell edhe nga vëzhguesit e partive politike dhe organizatat joqeveritare

**EPOKA  
ERE**

**Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 16 TETOR** - Në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) të mërkurën ka filluar procesi i numërimit të rreth 13 500 fletëvotimeve të diasporës të cilat kanë ardhur përmes postës gjatë periudhës së votimit 19 shtator - 5 tetor 2019. Në bazë të rezulttit të numërimit të vetëm 5 242 fletëvotimeve nga numri total 13 491 votave, Lëvizja

Vetëvendosje prin me 2 553 vota, e pasuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës me gjithsej 972 vota, ndërsa Partia Demokratike e Kosovës deri tani ka marrë 825 vota nga diaspora. Koalicioni AAK-PSD, në bazë të numërimit të këtyre fletëvotimeve, ka marrë 369 vota, kurse koalicioni Nisma-AKR-PD ka marrë gjithsej 356 vota. Numërimi i këtyre votave pritet të përfundojë të premtën. Në këtë proces nuk janë përfshirë pakot me fletëvotime që

kanë ardhur pas afatit ligjor. Zëdhënësi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valmir Elezi, ka thënë se deri tani nuk kanë hasur në ndonjë pengesë dhe se numërimi i votave me postë është përcjell edhe nga vëzhgues të partive politike dhe organizatat joqeveritare. Të mërkurën kryetarja e KQZ-së, Valdete Daka, ka parë nga afër në QNR procesin e numërimit të fletëvotimeve të ardhura me postë.

## Veseli takon Apostolovën, flasin për qëndrimet e PDK-së

**PRISHTINË, 16 TETOR (ER)** - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka pritur të mërkurën në takim shefen e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Nataliya Apostolova, me të cilën kanë diskutuar për zhvillimet e fundit politike në vend dhe për qëndrimet e PDK-së.

Lideri i PDK-së e ka informuar Apostolovën për qëndrimet e PDK-së si lidere e opozitës së ardhshme. "Gjatë takimit me shefen e zyrës së Bashkimit Evropian në Prishtinë, znj. Apostolova, diskutuam për zgjedhjet parlamentare në Kosovë dhe sfidat që na presin. Theksuam se procesi ishte në

përputhje me standardet më të larta të demokracisë duke dëshmuar një pjekuri të institucioneve tona. Partia Demokratike do të jetë një opozitë efikase dhe konstruktive që do të ketë në qendër të veprimtarisë të vet zërin e qytetarit dhe interesin e shtetit të Kosovës", ka thënë Veseli pas këtij takimi.







FLET PËR "EPOKËN E RE", JAKUP KRASNIQI

# Koalicioni Nisma-AKR-PD do të jetë pjesë e Kuvendit por, jo siç e kemi pritur

Kryetari i Këshillit Kombëtar të Nismës Socialdemokrate, Jakup Krasniqi, ka thënë se sovranit më 6 tetor e ka kryer detyrën e vet mirë, por ka pasur tentime të blerjeve të votave dhe deformim të rezultatit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se në procesin zgjedhor administrativisht ka pasur gabime jo të vogla, ku KQZ-ja e ka përgjegjësinë e vet. Krasniqi ka thënë se koalicioni Nisma-AKR-PD do të jetë pjesë e Kuvendit, ndonëse jo siç është pritur. Sipas tij, ky koalicion, siç duket, nuk është pranuar nga zgjedhësit. Krasniqi ka folur edhe për qeverinë e re, për të cilën ka thënë se do të ketë vështirësi pasi që partitë kanë dallime ideologjike. Ai ka theksuar se qeveria LV-LDK do t'i ketë sfidat të mëdha në disa rrafshe

të mirë të koalicionit parazgjedhor Nisma-AKR-PD, ai ka thënë se, siç duket, ky koalicion nuk u pranua nga qytetarët. "Si po duket koalicioni nuk është pranuar nga zgjedhësit. Këtë ata e treguan me votën e tyre", ka theksuar ai. Megjithatë, Krasniqi ka bërë me dije se koalicioni Nisma-AKR-PD do të jetë pjesë e Kuvendit, ndonëse jo siç është pritur. "Të gjitha informacionet që po vijnë po tregojnë se Nisma-AKR e PD do të jenë pjesë e Kuvendit, ndonëse jo siç e kemi pritur. Ne e kemi pritur një rezultat tjetër, duke pasur parasysh ofertën tonë dhe parimet e socialdemokracisë, por në Kosovë nuk votohet as

**EPOKA E RE****Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 16 TETOR - Ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, njëherësh kryetar i Këshillit Kombëtar të Nismës Socialdemokrate, Jakup

Krasniqi, ka thënë të mërkurën se procesi zgjedhor i 6 tetorit administrativisht ka pasur gabime jo të vogla për të cilat ka përgjegjësi edhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ). Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka

deklaruar se ka pasur tentime të blerjeve të votave dhe deformim të rezultatit nga komisionarët. "Nga ajo që shihet, sovranit e ka kryer detyrën e vet mirë, ndërsa pak ka pasur tentime të blerjeve të votave e nga komisionarët deformim të

rezultatit zgjedhor, sidomos në mes të kandidatëve ka pasur garë jokorrekte. Madje administrativisht ka pasur gabime jo të vogla, ku edhe KQZ-ja e ka përgjegjësinë e vet", është shprehur Krasniqi. Duke e komentuar rezultatin jo



*zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 6 tetorit dhe rezultatet e tyre?*

**Krasniqi:** Nga ajo që po shihet, sovrani e ka kryer detyrën e vet mirë, ndërsa pak ka pasur tentime të blerjeve të votave e nga komisionarët deformim të rezultatit zgjedhor, sidomos në mes të kandidatëve ka pasur garë jokorrekte. Madje administrativisht ka pasur gabime jo të vogla, ku edhe KQZ-ja e ka përgjegjësinë e vet.

**"Epoka e re":** *Çfarë mendoni se shkoi keq që koalicioni parazgjedhor, Nisma-AKR-PD, nuk i realizoi pritjet në këto zgjedhje?*

**Krasniqi:** Si po duket koalicioni nuk është pranuar nga zgjedhësit. Këtë ata e treguan me vota.

**"Epoka e re":** *Meqë ende nuk janë numëruar të gjitha votat e ardhura nga diaspora, a besoni se mund ta kaloni pragun zgjedhor?*

**Krasniqi:** Të gjitha informacionet që po vijnë po tregojnë se Nisma-AKR e PD do të jetë pjesë e Kuvendit, ndonëse jo siç e kemi pritur. Ne e kemi pritur një rezultat tjetër, duke pasur parasysh ofertën tonë dhe parimet e socialdemokracisë, por në Kosovë nuk votohet as për programet politike e zgjedhore e as për programin ideologjik.

**"Epoka e re":** *Duke pasur parasysh përvojën tuaj të gjatë në politikë, si e shihni funksionimin e qeverisë së ardhshme në mes të Lëvizjes Vetëvendosje dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës?*

**Krasniqi:** Nuk dëshiroj të paragjykoj për asgjë. Sigurisht se do të ketë vështirësi pasi partitë kanë dallime ideologjike. Por, pasi gara bëhet për pushtet, dallimet mund të shkrihen. Në rastin tonë duhet të presim si do t'i qasen qeverisjes dhe problemeve politike që i presin.

**"Epoka e re":** *Qeveria e ardhshme do të ketë para vetes shumë sfida si në aspektin e brendshëm, po ashtu edhe në atë ndërkombëtar, përfshirë këtu edhe dialogun me Serbinë. Do të mund t'u bëjë ballë kjo qeveri këtyre sfidave?*

**Krasniqi:** Sfidat e këtij koalicioni do të jenë të mëdha në tri rrafshë: Së pari do të kenë probleme me politikën në raport me vendet mbështetëse të Kosovës siç janë BE-ja dhe ShBA-ja. Së dyti me politikën serbe e cila vazhdon të jetë shumë armiqësore. Me këtë të fundit nuk e di se si do ta gjejmë gjuhën e dialogut. Së treti dhe kryesoret, janë problemet kryesore si zhvillimi ekonomik e punësimi, pastaj funksionimi i institucioneve të shtetit. Probleme në vete janë arsimit dhe shëndetësia me ndërmarrjet publike", ka theksuar Krasniqi.

**"Epoka e re":** *Z. Krasniqi, në përgjithësi si i vlerësoni*



## Thaçi: Kosova ka përfituar nga bashkëpunimi me EULEX-in

**PRISHTINA, 16 TETOR (ER)** - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka pritur të mërkurën në takim lamtumirës zëvendësuesin dhe ushtruesin e detyrës së shefit të misionit të EULEX-it, Bernd Thran, të cilin e

ka falënderuar për bashkëpunimin e shkëlqyer me institucionet e Kosovës. "U jam mirënjohës juve personalisht për angazhimin tuaj në misionin tonë të përbashkët të forcimit të sundimit të ligjit në Kosovë",

është shprehur presidenti Thaçi, duke e falënderuar atë për punën në Kosovë. Presidenti Thaçi ka thënë se Kosova ka përfituar shumë nga bashkëpunimi dhe shkëmbimi i përvojave me ekspertët e EULEX-it.



## Kurti dhe Demiri diskutojnë për sfidat e qeverisë së re

**PRISHTINË, 16 TETOR (ER)** - Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, është takuar me Rasim Demirin nga koalicioni VAKAT, me të cilin ka biseduar për procesin zgjedhor të 6 tetorit. Kurti dhe Demiri kanë folur edhe për zhvillimet në vend si dhe për

sfidat që e presin qeverinë e re. "Koalicioni VAKAT ka korrur rezultat shumë të mirë në zgjedhjet e 6 tetorit. Në Prizren ka dalë i katërti, menjëherë pas LV-së, PDK-së dhe LDK-së. Në legjislaturën e shtatë do t'i ketë dy deputetë. Me z. Rasim Demiri u

takuar sot dhe i uruam sukses njëri-tjetrit. Biseduam për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, gjendjen e komunitetit boshnjak dhe sfidat socio-ekonomike e politiko-institucionale të shtetit të Kosovës e qeverisë sonë të re", ka thënë Kurti pas takimit.



# Lobi Rajonal i Grave të Evropës Jug-Lindore mbajti takim në Prishtinë, diskutohet për zhvillimet në rajon

PRISHTINË, 16 TETOR (ER) - Lobi Rajonal i Grave të Evropës Jug-Lindore (LRGEJL), me kryesimin e Edita Tahirit, mbajti mbledhjen në Prishtinë. Në këtë mbledhje u diskutua për zhvillimet në rajon dhe për rritjen e rolit të grave për konsolidim të paqes, prosperitetit dhe stabilitetit në Kosovë dhe rajon, duke nënvizuar rëndësinë e përshejtimit të integritimit euroatlantik. Në këtë takim u tha se paqja dhe ardhmëria e ndritur vijnë kur gratë dhe burrat janë të barabartë në vendimmarrje.

Me këtë rast, lobi u zgjerua me anëtare të reja, përfshirë gratë në politikë dhe deputetet Hykmete Bajrami, Xhevahire Izmaku, Time Kadrijaj dhe nga shoqëria civile, Arjeta Rexha. Edita Tahiri ka falënderuar anëtarët e reja dhe u ka uruar punë të mbarë në misionin e përbashkët për fuqizimin e grave në vendimmarrje dhe procese të paqes, stabilitetit dhe mirëqenies në Kosovë dhe rajon. Përbërja e plotë e lobit në Kosovë është: Edita Tahiri, krye-

suese, Teuta Sahatqija, Luljeta Vuniqi, Hykmete Bajrami, Xhevahire Izmaku, Time Kadrijaj, Arjeta Rexha si dhe sekretariati i lobit në përbërje: Diana Çekaj-Berisha, koordinatore dhe Arbëresha Dedinja, asistente e projektit. Lobi Rajonal i Grave në Evropën Jug-Lindore (LRGEJL) vazhdimisht avokon për bashkëpunim të zgjeruar midis grave nga Ballkani Perëndimor dhe fuqizimin e rritur të grave në qeverisjen demokratike dhe proceset e ndërtimit të paqes.



# Tahiri: Ministria e Drejtësisë nuk ka pranuar ekspertizën e rastit Dehari

PRISHTINË, 16 TETOR (ER) - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka reaguar rreth pretendimeve të avokatit Tomë Gashi në lidhje me pranimin e raportit përfundimtar të ekspertizës së Astrit Deharit nga instituti zviceran. "Deklarimet e avokatit Tomë Gashi, të shfaqura në publik, në lidhje me pranimin e raportit përfundimtar të ekspertizës për rastin e Astrit Deharit nga Ministria e Drejtësisë, janë pretendime të pavërteta, tendencioze dhe absolutisht joprofesionale. Për hir të informimit të drejtë të opinionit dëshiroj t'ju njoftoj se asnjë dokument me çfarëdo përmbajtje që lidhet me rastin Dehari nuk ka arritur në adresë të Ministrisë së Drejtësisë. Profesionalisht avokati Gashi është dashur ta dijë se kjo çështje u takon organeve të zbatimit të ligjit dhe jo Ministrisë së



Drejtësisë", ka thënë Tahiri. Ai ka shtuar se roli i tij si ministër i Drejtësisë, pasi ka marrë mandatin, ka qenë trajtimi i nevojshëm, sipas kërkesës së familjes Dehari, për të mundësuar një super-ekspertizë jashtë vendit në një prej qendrave më të njohura të mjekësisë ligjore në Evropë. "Me kohë kemi siguruar edhe mjetet financiare për ekspertizën dhe organet e pavarura të

sundimit të ligjit janë vënë në kontakt me Institutin e Lozanës në Zvicër, që ishte preferenca e familjes Dehari. Andaj pretendimet e avokatit Gashi janë të pabaza, joprofesionale dhe tendencioze prapa të cilave fshihet mungesa e njohurive procedurale dhe, për më tutje, nuk e informojnë opinionin publik në mënyrë të drejtë", ka deklaruar Tahiri.

# Tërnavë shkon për ngushëllime në familjen e hoxhë Avdyl Krasniqit

SKENDERAJ, 16 TETOR (ER) - Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët, ka shkuar për ngushëllime në familjen e hoxhë Avdyl ef. Krasniqit. Myftiu

Tërnavë çmoi lart punën dhe kontributin fetar dhe atdhetar të imanit Avdyl ef. Krasniqi. Ai bëri lutje që Zoti ta ketë shpërblyer me xhenet punën dhe veprën e hoxhës, e për shpirt të tij kënduan nga një fatiha.



# Mbahet ligjëratë për kancerin e gjirit

PRISHTINË, 16 TETOR (ER) - Në bashkëpunim me Klinikën e Kirurgjisë Plastike, Shoqata e Kirurgëve Plastikë, Konstruktivë dhe Estetikë, me

rastin e muajit të ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit, ka mbajtur një ligjëratë për rikonstrukcionin e gjirit. Leksionet e kësaj natyre kanë

për qëllim t'i informojnë të gjitha femrat e operuara nga kanceri i gjirit, se në QKUK, me metoda bashkëkohore, mund të bëhet rindërtimi i gjirit.





Zgjerohen hetimet për vrasjen e Oliver Ivanoviçit

# Arrestime të reja në veri për vrasjen e Ivanoviçit

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka marrë vendim për zgjerim të hetimeve për vrasjen e Oliver Ivanoviçit edhe për dy zyrtarë policorë në veri të Mitrovicës. Për këtë qëllim, policia ka ndërmarrë një aksion të mërkurën, në të cilin ka arritur të arrestojë vetëm hetuesin policor Rade Basara, por jo edhe shefin e operativës së policisë për rajonin e Mitrovicës së Veriut, Zheljko Bojiq

Milan Radoiçiq, për të cilin, sipas tij, është lëshuar fletarrestim ndërkombëtar. "Në shkresat e lëndës, të cilat i kemi, grupi kriminal i Milan Radoiçiqit është mjaft i organizuar dhe ka ndikim, për fat të keq, edhe në Policinë e Kosovës, por edhe në strukturat e tjera komunale apo shtetërore të asaj pjese. Prandaj këta dy persona, për të cilët i kemi zgjeruar hetimet para dy apo tre ditëve, kemi prova që edhe këta kanë punuar dhe vepruar nën urdhrat e Milan Radoiçiqit dhe të grupit të tij", ka thënë Hoxha. Ai ka shtuar se personat për të cilët janë

zgjeruar hetimet dhe për personin ndaj të cilit është kërkuar caktimi i paraburgimit dyshohen se nuk i kanë kryer veprimet e duhura procedurale ose me qëllim i kanë fshehur disa veprime që është dashur t'i ndërmarrin apo t'i sigurojnë provat në raste të ndryshme të vrasjeve dhe jo vetëm në rastin e vrasjes së Ivanoviçit.

Kurse zëdhënësi i Policisë së Kosovës, Baki Kelani, ta treguar për lokacionet ku është zhvilluar ky operacion. "Në tri lokacione janë kryer bastisje dhe kontrolle për veprat penale organizim i grupit kriminal dhe keqpërdorim i detyrës zyrtare. Personi i

dytë i kërkuar nuk është gjetur në vendet e kontrolluara. Policia e Kosovës gjatë këtij operacioni ka arritur t'o konfiskojë gjashtë armë, prej tyre dy zyrtare, por edhe gjëra të tjera", ka deklaruar Kelani. Ai ka treguar se kush ka qenë në dijeni të këtij operacioni. "Ne si Polici e Kosovës pjesë të operacionit kemi pasur edhe policët në kufi. Policia e Kosovës i ka adresuar informacionet edhe të shtetave të tjera pasi në medie është thënë se ai është në Mal të Zi. Pra, kemi kërkuar edhe nga shtetet e tjera informacione dhe bashkëpunim", ka deklaruar Kelani.

**EPOKA  
ERE****Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 16 TETOR** - Policia e Kosovës ka zhvilluar një aksion të mërkurën në veri të Kosovës, ku ka arrestuar një zyrtar policor në lidhje me vrasjen e politikanit serb Oliver Ivanoviç. I arrestuari është hetues policor, Rade Basara. Policia nuk ka arritur ta zë të dyshuarin tjetër, shefin e operativës së policisë për rajonin e Mitrovicës së Veriut, Zheljko Bojiq. Fillimisht policia ka arrestuar djalin e këtij të fundit i cili, pas intervistimit, është liruar. Pas këtij aksioni Prokuroria Speciale dhe Policia e Kosovës kanë mbajtur konferencë për media në të cilën kanë folur për aksionin.

Prokurori i Prokurorisë Speciale të Kosovës, Sylë Hoxha, ka treguar se më 14 tetor është marrë vendim për zgjerim hetimesh edhe për dy zyrtarë policorë të veriut. "Gjatë orëve të hershme është arrestuar njëri, kurse tjetri është ende në kërkim. Hetimet janë zgjeruar për veprat penale organizim ose pjesëmarrje në grup të organizuar kriminal dhe keqpërdorim i detyrës zyrtare. E kam intervistuar personin e arrestuar dhe kam kërkuar masën e paraburgimit për të. Për personin që i është gjetur arma dhe nuk ka qenë i kërkuar, është liruar pas inter-

vistimit. Dyshohet për armëmbajtje pa leje", ka thënë Hoxha. Prokurori Hoxha ka theksuar se në veriun e Kosovës ekzistojnë grupe kriminale të organizuara mirë dhe të udhëhequra nga



## Burim Ramadani: Ministrat dhe zëvendësministrat të kalojnë nëpër verifikim të sigorisë

**EPOKA  
ERE****Qendresa RAMA**

**PRISHTINË, 16 TETOR** - Zëvendësministri në largim i Mbrojtjes, Burim Ramadani, ka thënë se ministrat dhe zëvendësministrat duhet të kalojnë nëpër verifikim të sigorisë. "Do të doja që ministrat dhe zëvendësministrat, jo vetëm të qeverisë që krijohet pas këtyre zgjedhjeve,

por gjithmonë t'i nënshtrohen verifikimit të sigorisë. Si zëvendësministër iu nënshtrova verifikimit të sigorisë. Pra, 'vetting'-ut që po i referohemi kryesisht në publik. Verifikimi i sigorisë është proceduralisht e përmbajtësisht krejt i njëjtë me vettingun", ka theksuar Ramadani.

Ai ka shtuar se në janar të vitit 2019, pas procesit disamujsh të kontrollit mbi të dhe familjen e

tij, i është dhënë drita e gjelbër që e kaluara dhe e tashmja e tij dhe e familjes është në rregull në të gjitha dimensionet. "Iu nënshtrova, sepse besoj në thelbin e sundimit të ligjit. Besoj në konceptin e sigorisë shtetërore. Besoj në domosdoshmërinë që të emëruarit politikë të dihet kush janë, çfarë të kaluare kanë, çka bëjnë sot, çfarë pasurie saktesisht kanë, çfarë transaksione

bankare kanë bërë për më shumë se një dekadë, me kënd shoqërohen dhe çka mendojnë fqinjët. Unë do të angazhohem 100 për qind që verifikimi i sigorisë të ndodhë për të gjithë zyrtarët e shtetit ashtu sikurse e parasheh Ligji për Klasifikim të Informacionit dhe Verifikim të Sigorisë", ka thënë Ramadani. Ligji parasheh që vetëm tre zyrtarë të shtetit, presidenti,



kryetari i Kuvendit dhe kryeministri nuk e kanë të domosdoshme ta kalojnë verifikimin e sigorisë.



# Thesari Amerikan premtion vazhdimin e mbështetjes për Kosovën



Ministri i Financave në largim, Bedri Hamza, ka marrë mbështetjen e Thesarit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Ministrinë e Financave me asistencë teknike. Zyrtari i lartë i Thesarit të Departamentit të Shtetit, Larry McDonald, ka përgëzuar ministrin Hamza për stabilitetin makro-fiskal që ka arritur t'i sigurojë shtetit të Kosovës kujdesin e treguar me borxhin shtetëror si dhe masat fiskale të ndërmarra

**EPOKA E RE**

**Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 16 TETOR** - Ministri i Financave në largim, Bedri Hamza, në kuadër të vizitës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ka zhvilluar takime edhe në Thesarin e Departamentit të Shtetit Amerikan ku është pritur nga zyrtari i lartë Larry McDonald.

Ministri Hamza e ka njoftuar McDonaldin për përparimin që ka bërë shteti i Kosovës në zhvillimin ekonomik dhe financiar, me

stabilitetin makro-fiskal, me borxhin e ulët që ka menaxhuar shteti i Kosovës, efektin e masave fiskale të ndërmarra për ta ndihmuar zhvillimin e sektorit privat si dhe me sfidat që ka shteti i Kosovës për rrugën e saj të zhvillimit ekonomik në të ardhmen. Hamza ka falënderuar Thesarin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për mbështetjen e Ministrisë së Financave dhe institucioneve të tjera të shtetit të Kosovës për zhvillimin e tyre, një ndihmë që, sipas tij, ka lënë gjurmë në zhvillimin e institucioneve të Kosovës.

Ndërkaq McDonald e ka falënderuar ministrin Hamza për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm që ka Ministria e Financave me Thesarin Amerikan dhe ka shprehur zotimin që edhe në të ardhmen Thesari do ta mbështesë Ministrinë e Financave me asistencë teknike.

Po ashtu, McDonald ka përgëzuar ministrin Hamza për stabilitetin makro-fiskal që ka arritur t'i sigurojë shtetit të Kosovës kujdesin e treguar me borxhin shtetëror si dhe masat fiskale të ndërmarra në dy vjet për sektorin privat.

## Sindikata e Doganës nuk e përkrah udhëzimin e ri administrativ dhe konkurset e hapura

**PRISHTINË, 16 TETOR (ER)** - Sindikata e Pavarur e Doganës së Kosovës përmes një komunikate për medie ka njoftuar se kjo sindikatë ka mbajtur një takim të menjëhershëm për të analizuar dhe diskutuar udhëzimin e ri administrativ.

Sindikata ka njoftuar se SPDK-ja ka qenë e ftuar të marrë pjesë në grupin punues për draftimin e këtij udhëzimi dhe ka dhënë

propozimet e saj me qëllim të sigurimit të barazisë së stafit dhe respektimin e parimeve të përgjithshme mbi marrëdhënien e punës. "SPDK ka vërejtur se në UA të publikuar propozimet e sindikatës nuk janë marrë për bazë, andaj mbi këtë bazë kryesia e SPDK-së ka vendosur që të mos e përkrahë UA 60/2019 dhe të gjitha konkurset e brendshme apo të jashtme të

bazuara në këtë udhëzim ne nuk do t'i përkrahim dhe do t'i atakojmë", thuhet në komunikatën e dërguar nga Sindikata e Doganës.

SPDK-ja ka njoftuar se do t'i ndërmarrë të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme ligjore për ta kundërshtuar këtë udhëzim, krejt kjo për ta siguruar trajtimin e barabartë të stafit.





# Posta lëshon në përdorim pullën '30 vjetori i grevës së minatorëve'

Prishtinë, 16 tetor (ER) - Posta e Kosovës ka lëshuar të mërkurën në qarkullim të jashtëzakonshëm emisionin e pullës postare me titull "30 vjetori i grevës së minatorëve". Përmes pamjes së pullës postare nderohet kontributi i minatorëve të "Trepçës" për mbrojtjen e autonomisë së Kosovës që në vitin 1989 regjimi ish-jugosllav kishte filluar ta rrënojë me forca policore dhe ushtarake.

Në galerinë e horizontit 10 të minierës ishin ngjuar 1 300 minatorë në grevë urie, të gat-

shëm për ta flijuar edhe jetën për interesat tona kombëtare, për dinjitet të popullit dhe brezave tanë të ardhshëm.

Greva e minatorëve u shndërrua në rezistencë gjithëpopullore, me një sensibilizim të jashtëzakonshëm ndërkombëtar që pati për vuajtjet e popullit shqiptar të shtypur nën egërsinë e regjimit të ish-Jugosllavisë.

Mbi 1 200 minatorë u dënuan me nga 30 e nga 60 ditë heqje lirie, ndërsa ndaj organizatorëve dhe udhëheqësve të kombinatit u zhvilluan procese monstruoze

politike. Përkundër dhunës serbe, forcohej rezistenca e popullit shqiptar dhe vendosmëria për realizimin e aspiratës shekullore, që kulmoi me luftën e armatosur të UÇK-së dhe me përkrahjen e NATO-së, të cilat sollën çlirimin e Kosovës më 12 qershor 1999.

Filatelia e Postës së Kosovës ka njoftuar se do të kujdeset që përmes kësaj pulle postare ta prezantojë rrugëtimin e popullit tonë deri te liria.

Greva e minatorëve ishte një prej ngjarjeve të mëdha historike të shtetit të Kosovës.



## Ministria e Tregtisë shënon Ditën Botërore të Standardeve



Prishtinë, 16 tetor (ER) - Dita Botërore e Standardeve 2019 u shënuar të mërkurën në Prishtinë nga Agjencia Kosovare për Standardizim (AKS), agjenci në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI).

Zëvendësministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bekim Jupa, ka thënë se AKS-ja do të ofrojë shërbime sa më të afërta për bizneset dhe palët e tjera të interesit. Jupa ka theksuar se MTI-ja mbështet

Agjencinë për ngritjen kapaciteteve saj si dhe për plotësimin e Ligjit për Standardizim përmes udhëzimeve administrative që standardet të zbatohen në shkallë të dëshiruar. "Standardet janë në shërbim të globalizimit të tregut duke ofruar konkurrueshmëri të ndershme dhe produkte cilësore dhe të sigurta", është shprehur Jupa.

Ndërsa udhëheqës i ekipit për

Seksionin e Zhvillimit Ekonomik dhe Bashkëpunimit Zyra e BE-së në Kosovë, George Papagiannis, ka thënë se sot në Ditën Botërore të Standardeve po shprehim mirënjohjen ndaj punës që bëjnë mijëra ekspertë që zhvillojnë standarde në mbarë botën dhe i shkëmbejnë ato vullnetarisht. "Standardizimi evropian ka rëndësi të madhe në tregun e përbashkët të BE-së, duke kontribuar në integrimin e

këtij tregu dhe mbështet konkurrueshmërinë, krijimin e vendeve të punës, inovacionin dhe industrinë", ka thënë Papagiannis. Sipas AKS-së, kërkesa për standarde në Kosovë çdo vit shënon rritje. Ndërsa gjatë vitit të fundit Agjencia ka nënshkruar marrëveshje me organizatat evropiane të standardizimit CEN CENELEC, për të siguruar qasje në standardet evropiane.

Drejtori i përgjithshëm i AKS-së, Hafiz Gara, prezantoi strategjinë pesëvjeçare të agjencisë - "Një vizion i ri në standardizim".

Agjencia Kosovare e Standardizimit përkrahet nga projekti i financuar nga Bashkimi Evropian, "Lëvizja e Lirë e Mallrave" me praktikat më të mira evropiane të standardizimit si një ndër shtyllat më të rëndësishme të infrastrukturës së cilësisë.



## Në Prizren diskutohet për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në komunitet

PRIZREN, 16 TETOR (ER) - Nën kryetari i Komunës së Prizrenit, Eshref Memaj, drejtoresha e Drejtorisë Komunale të Arsimit, Xhemile Thaçi Vezgishi morën pjesë në takim koordinues lidhur me parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në komunitet, ku pjesëmarrës

ishin edhe përfaqësues të organizatës IOM, Zyrës së Koordinatorit Nacional kundër Ekstremizmit dhe Terrorizmit, përfaqësues të bashkësive fetare, Policisë së Kosovës, OSBE-së, si dhe institucioneve të tjera relevante që janë faktorë me rëndësi lidhur me këtë çështje.



Në këtë takim u bë vlerësimi i Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm që çon në terrorizëm 2015-2020 dhe u dhanë reko-

mandime për përpilimin e strategjisë së re për periudhën 2020-2025.

Struktura për parandalimin e ekstremizmit në nivel qendror

dhe lokal në Republikën e Kosovës u prezantua nga këshilltarja e Koordinatorit Nacional kundër Ekstremizmit dhe Terrorizmit, Mimoza Hasani Pllana.

## Ndërtimi i shtëpive për familjet në nevojë në Drenas, afër përfundimit

DRENAS, 16 TETOR (ER) - Punimet për ndërtimin e shtatë shtëpive për familjet në nevojë nga Komuna e Drenasit, në bashkëpunim me shoqatën bamirëse "Jetimat e Ballkanit", janë afër përfundimit. Sipas kësaj marrëveshje të bashkëfinancimit, Komuna e Drenasit ka ndarë 35 000 euro, 5 000 për secilën shtëpi, ndërsa pjesa

tjetër mbetet nga shoqata "Jetimat e Ballkanit" përmes donatorëve.

Deri tani punët për ndërtimin e këtyre shtëpive kanë shkuar mirë dhe në afat të shkurtër kohor, ka përfunduar puna e vrazhdë dhe instalimet. Brenda këtij viti familjet në nevojë do t'i marrin çelësat e këtyre shtëpive, të cilat përmbushin

kushtet për një jetë të dinjitetshme.

Kryetari i komunës, Ramiz Lladrovci, ka falënderuar Halil Kastratin dhe të gjithë donatorët që kanë participuar që t'i ndihmojnë familjet në nevojë dhe është zotuar se do t'i përmbushë të gjitha detyrimet që dalin nga kjo marrëveshje bashkëfinancimi.



## Fillon ndërtimi i parkut në fshatin Pataqan i Ulët në Rahovec

RAHOVEC, 16 TETOR (ER) - Në fshatin Pataqan i Ulët ka filluar të mërkurën projekti i ndërtimit të parkut të këtij fshati. Në kuadër të këtij projekti parashihet një hapësirë e madhe e gjelbëruar, me parking për vetura, kënd lojërash për fëmijë, kënd basketbolli për të rinj dhe ulëse përgjatë

rrugicave të parkut. "Në kontratën që kemi lidhur, përveç këtij parku, parashihet edhe ndërtimi i shtatë parqeve të tjera, të cilat do të ndërtohen në Sapniq, Celinë, Zoqisht, Malësi e Vogël, Ratkoc, Dobidol dhe Senoc", ka thënë kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi.



## Vazhdojnë punimet për meremetimin e tërësishëm të shkollës 'Vesel Pagarusha'

MALISHEVË, 16 TETOR (ER) - Punimet në meremetimin e objektit të Shkollës Fillore dhe të Mesme të Ulët "Vesel Pagarusha" në Pagarushë janë duke vazhduar dhe shumë shpejt pritet të përfundojnë meremetimi, izolimi dhe vendosja e ngrohjes qendrore. Punimet në këtë shkollë i ka inspektuar kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, i cili është njoftuar nga drejtori i

kësaj shkolle, Astrit Krasniqi, me ecurinë e punimeve të deritanishme.

Sipas drejtorit Krasniqi, punimet janë duke vazhduar sipas planifikimit, ndërsa përveç meremetimit të brendshëm të objektit, që është bërë para fillimit të procesit mësimor, është bërë rregullimi i kulmit të shkollës, është duke u bërë izolimi i tërësishëm, si dhe është duke u punuar për

rregullimin e sistemit të ngrohjes.

Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, është ndarë i kënaqur me punimet e deritanishme dhe ka kërkuar nga punëkryesi që punimet të jenë cilësore dhe mos të ketë vonesa për realizimin e këtij projekti.

Meremetimi i objektit të ShMU "Vesel Pagarusha" do të kushtojë mbi 130 mijë euro.





# PDK-ja realizoi projekte të mëdha, por do të mbahet mend për gjëra të vogla



**Ahmet JASHARI**

Parimi fetar se nëse bën një të keqe atëherë bëje një të mirë për ta mbuluar atë nuk vlen në politikë. Madje në politikë mjafton vetëm një e keqe që ta zhbëjë krejt të mirën. Këtë e dëshmon rrugëtimi politik i PDK-së që ka nisur me projekte të mëdha dhe ka përfunduar tashmë në opozitë me damkën e së keqes. Askush nuk mund ta mohojë atë që e thonë drejtuesit e PDK-së, se të gjitha proceset që lidhen me shtetndërtimin e

Republikës së Kosovës që 20 vjet e kënde mbajnë vulën e lidërshiptit të kësaj partie. Konferenca e Rambujesë është drejtuar nga liderët e UÇK-së që u bënë liderë të PDK-së. Në procesin e Vjenës të drejtuar nga presidenti Marti Ahtisari, që rezultoi me pavarësinë e Kosovës, PDK-ja tregoi një pjekuri të jashtëzakonshme duke e dhënë kontributin e vet nga opozita. Vetëm disa muaj pasi erdhi në pushtet, lideri i atëhershëm i PDK-së, Hashim Thaçi, shpalli pavarësinë e Kosovës, duke hyrë në histori. Pasuan mandej projektet e mëdha si autostradat, objektet shkollorë, infrastruktura në përgjithësi, pagat etj, të cilat po ashtu mbajnë vulën e PDK-së. Me një fjalë Kosova u bë e pavarur dhe mori pamjen e një shteti normal. Këto momente

madhështie në rrugëtimin e kësaj partie, i verbuan të fortët e PDK-së. Ata u shkëputën nga qytetarët e rëndomtë, shumë prej tyre u pasuruan, u tjetërsuan. Nuk ishin më ata të zakonshmit. Pjesa tjetër e qytetarëve për ta dukej e vogël, e pafuqishme. Ata kishin rroba të shtrenjta, vetura luksoze dhe sjellje jonormale. Nuk ishin më ata djemtë e fshatit që ndanin një copë bukë. Nuk ishin më ata luftëtarët e UÇK-së që mbronin njëri-tjetrin dhe vendin e tyre me trupat e tyre. Nuk u pëlqente më shoqëria e vjetër. Kërkonin diçka të re. U pëlqenin të tjerët, ndonjëherë edhe ata që kishin qenë më afër pushtuesit së popullit të vet. Degradoi gjithçka. Nuk dihej më se kush ishte luftëtari, patrioti apo tradhtari i vërtetë. E gjithë kjo i hapi rrugën së

keqes, që u derdh në shoqërinë tonë me gjithë vrullin e vet. Nuk kishte mbetur asnjë vlerë që mund t'i referohej dikush apo që do të pranohej si e tillë nga të gjithë. Figurat kombëtare më shumë u abuzuan sesa u nderuan dhe respektuan. Po ashtu, u veprua edhe me familjarët e tyre. U ngritën shtatore në gjithë vendin, pa kriteret e shumë herë me forcë. U bënë heronj të gjithë dhe veteranë të gjithë. Bashkëluftëtarët e Adem Jasharit, lufta dhe sakrificat e të cilit trandi një botë të tërë, për 12 vjet në pushtet nuk e morën me vete Adem Jasharin në Prishtinë. Adem Jashari tani është në Tiranë. Ai është gjithkund ku ka shqiptarë dhe njerëz që e respektojnë sakrificën për liri, por ai nuk është në kryeqytetin e Republikës së

Kosovës. Adem Jashari gjithsesi do të vijë në Prishtinë, por duket se nuk do t'i gjejë aty ata që dikur kishin ndjekur rrugën e tij. Të paktën edhe nëse i gjen ata do të jenë të tjetërsuar. Nëse ndahesh prej shokëve tjetërsoshesh. Ata e kanë bërë një gjë të tillë, prandaj kanë dalë në opozitë me damkën e së keqes. Nuk përmenden më sot projektet e mëdha, por problemet ditore, si: papunësia, korrupsioni etj. PDK-ja realizoi projekte të mëdha, por do të mbahet mend për gjëra të vogla. Nevojat dhe kërkesat e qytetarëve kanë ndërruar dhe ata nuk kanë ditur të përshtaten. Qytetarët kanë bërë një zgjedhje tjetër, megjithëse të pasigurt. Më tepër kanë preferuar të panjohurën sesa të njohurën që ka degraduar.

## Qëndrim neveritës dhe cinik i Edi Ramës

"Kurrë nuk kam menduar se do të më vinte për të vjellë" nga reagimi i një kryeministri shqiptar!



**Bardhyl MAHMUTI,**  
politolog

Më 10 tetor 2019, pas takimit në Novi Sad me kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama, dhe me kryeministrin e Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, presidenti i Serbisë, Aleksandar Vučić, pohoi për mediet se "është nënshkruar deklarata e përbashkët, e cila bazohet në zbatimin e lëvizjes së lirë të mallrave, kapitalit, njerëzve dhe shërbimeve ndërmjet këtyre shteteve". Përpjekja për krijimin e të ashtuquajturit "Shengen Ballkanik", ku nuk ishte ftuar as Kosova e as Mali i Zi, nuk ishte asgjë tjetër pos përpjekje për ta realizuar

planin hegjemonist serb në këtë pjesë të Evropës Juglindore. Reagimet e shumta për praninë e Shqipërisë në një takim të tillë tendencioz u injoruan tërësisht nga kryeministri Rama. Në të njëjtën ditë, kryeministri Rama reagoi lidhur me vendimin e Akademisë Suedeze, që i dha shkrimtarit austriak Peter Handke çmimin "Nobel" në letërsi për vitin 2019. Përmes rrjetit social "Twitter", Edi Rama shkruan: "Kurrë nuk kam menduar se do të më vinte për të vjellë, për shkak të çmimit "Nobel". Por paturpësia po bëhet pjesë normale e botës që jetojmë. Fituesi i çmimit "Nobel" në letërsi është një zgjedhje e turpshme e Akademisë Suedeze. Nuk mundet që të jemi kaq të mpirë ndaj racizmit dhe gjenocidit". Katër ditë më vonë, në një shkrim autorial për medien "Politico Europe", kryeministri Rama tregon arsyet e veta se përse është tronditur nga një vendim i tillë i Akademisë

Suedeze. Nga të gjitha arsyet që përmend në shkrimin e tij, kryeministri i Shqipërisë veçon dy: çështjen e përshkrimit që Peter Handke u bën serbëve si "njerëz të thjeshtë, të zakonshëm (...), duke ngrënë sarma, kajmak dhe duke pirë verë Smedereve, atje ku Danubi rrjedh pa zhurmë, (...), si njerëz që janë thellësisht të prekur nga përbuzja e pjesës tjetër të Evropës (...)" dhe çështjen e "heshtjes së Peter Handkes për rolin e Serbisë në tragjedinë e Ballkanit gjatë viteve '90-ta dhe sidomos në gjenocidin e Srebrenicës, në Bosnjë". Kryeministri Edi Rama ka plotësisht të drejtë: "Paturpësia po bëhet pjesë normale e botës që jetojmë". Nuk mund të ketë paturpësi më të madhe, sesa të kritikohet Peter Handke pse hesht për rolin e Serbisë në tragjedinë e Ballkanit, të përmenden rastet e veçanta të krimeve serbe dhe të mos thuhet asnjë fjalë e vetme për gjenocidin që Serbia ka kryer në Kosovë. Të citohet vendi, ku për Peter Handken "Danubi rrjedh pa zhurmë" dhe të mos përmendet fare përpjekja e shtetit serb për të fshehur kamionët-frigoriferë me kufoma fëmijësh, grash dhe pleqsh shqiptarë "në ujërat e qeta të Danubit" është paturpësi. Sidomos kur një kryeministri të

Shqipërisë nuk i kujtohet se në lumin Danub, në vendin Tekija të Kladovës, kufomat e civilëve shqiptarë nxorën në sipërfaqe të ujërave edhe përpjekjen e fshehtë të kriminit të gjenocidit ndaj shqiptarëve. Të flitet për serbët si për "njerëz që janë thellësisht të prekur nga përbuzja që u ka bërë Evropa" dhe të mos përmendet se nuk ka përbuzje më të madhe sesa mosndëshkimi i kriminelëve që vranë 1392 fëmijë shqiptarë, 1739 gra shqiptare, rreth 10 000 civilë të tjerë shqiptarë të të gjitha moshave, që dhunuan mbi 20 mijë femra shqiptare dhe që dëbuan rreth 1 milion shqiptarë gjatë spastrimit etnik të Kosovës

kjo është paturpësi e madhe! Nuk habitem që gjenocidi që ka kryer Serbia ndaj shqiptarëve të Kosovës lihet në heshtje nga Peter Handke, Regi Debray, Jean-Arnault Dérens, Pierre Péan apo intelektualë të tjerë, që në Serbi kanë ngrënë "sarma, kajmak dhe kanë pirë verë Smedereve". Por të heshtë për këtë gjenocid një kryeministër shqiptar është arsye, nëse parafrazoj thënien e Edi Ramës, do të thosha: "Kurrë nuk kam menduar se do të më vinte për të vjellë" nga reagimi i një kryeministri shqiptar! Të shpresojmë që kjo paturpësi të mos bëhet pjesë normale e botës shqiptare!





## Franca dhe Gjermania pajtohen para takimit të udhëheqësve të BE-së

BERLIN, 16 TETOR - Udhëheqësit e Francës dhe Gjermanisë do t'i bashkërendisin qëndrimet për çështje të ndryshme me të cilat përballlet blloku evropian, që përfshijnë procesin e daljes së Britanisë së Madhe nga BE-ja dhe deri te situata në Siri. Koordinimi ndërmjet gjermanëve dhe francezëve ndodh para një takimi të udhëheqësve të shteteve dhe qeverive të BE-së që

do të mbahet më 17 dhe 18 tetor në Bruksel. Presidenti francez, Emmanuel Macron dhe kancelarja gjermane, Angela Merkel, do t'i zhvillojnë bisedimet në qytetin francez jugperëndimor, Toulouse. Ata do të fokusohen se si të ecet përpara me projektet evropiane në politikën e jashtme, mbrojtjen dhe energjinë. Merkel ka thënë se bashkë me

Macronin dëshiron të shkojë në Bruksel me "sa më shumë pozicione të përbashkëta, që të jetë e mundur". Shefja e ardhshme e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, gjithashtu do t'iu bashkohet bisedimeve të Merkelit dhe Macronit. Presidenti francez, Emmanuel Macron, tha më herët se kjo është një kohë "shqetësuese" për rendin ndërkombëtar.



# Hetimi për shkarkimin e presidentit Trump

Shtëpia e Bardhë ka kundërshtuar bashkëpunimin me hetimin dhe ka kritikuar faktin e mungesës së një votimi në Dhomën e Përfaqësuesve që duhet të kishte vendosur nëse duhet të niste ose jo hetimi për ngritjen e akuzave për shkarkimin e presidentit

WASHINGTON, 16 TETOR - Një zyrtar i lartë i Departamentit të Shtetit u tha ligjvënësve të Dhomës së Përfaqësuesve të martën se zyrtarë të administratës i kishin thënë atij "të mos merrej" me çështjet e lidhura me Ukrainën në respekt të atyre që zyrtari i quajti si "three amigos" ("tre miqtë"), të cilët, sipas tij, kishin marrë kontrollin e politikës së jashtme në raport me Kievin. Ligjvënësi demokrat Gerald Connolly u tha gazetarëve se George Kent u kishte folur rreth një takimi në Shtëpinë e Bardhë më 23 maj, gjatë së cilit shefi në detyrë i kabinetit të presidentit Donald Trump, Mick Mulvaney, kishte vendosur në krye të punëve që lidhen me Ukrainën, sekretarin e Energjisë Rick Perry, ambasadorin amerikan në Bashkimin Evropian Gordon Sondland si dhe të dërguarin amerikan në Ukrainë Kurt Volker. Sipas dëshmisë së Kent, ata e "quanin veten si tre miqtë" dhe po kështu edhe në prani të presidentit të Ukrainës Volodymyr Zelenskiy gjatë një takimi në Kiev, tha ligjvënësi Connolly. Connolly tha se Kent u kishte thënë ligjvënësve se administrata Trump po vononte ndihmën ushtarake ndaj Ukrainës ndërsa

nxiste Zelenskiy që të hetonte një kompani të lidhur me djalin e kundërshtarit të tij politik Joe Biden.

Ndërkohë të martën ligjvënësi demokrat Adam Schiff tha se kundërshtitë për të dëshmuar apo sjellë dokumente në hetimet për shkarkimin e presidentit nga ana e përfaqësuesve të administratës Trump dhe avokatit personal të presidentit, Rudy Giuliani po vazhdojnë të ndërtojnë një çështje për t'u hetuar siç është ajo e pengimit të drejtësisë.

Zyra e nënpresidentit Mike Pence tha se hetimi që po kryen Dhoma e Përfaqësuesve nuk ka marrë miratim, ndërsa kërkesat zyrtare për dëshmi dhe dokumente "kanë një subjekt tejet të gjerë". Zyrtarët e Pentagonit njoftuan se aktualisht nuk do të jenë në gjendje të pajtohen me kërkesat e Kongresit për arsye ligjore.

Zyra e buxhetit e Shtëpisë së Bardhë e hodhi poshtë kërkesën e Kongresit dhe po kështu avokati personal i Trumpit, Rudy Giuliani, i tha jo kërkesës zyrtare për të dërguar në Kongres dokumente që lidhen me përpjekjet e dyshuara të tij për t'i bërë presion Ukrainës për të hetuar ish-nënpresidentin dhe kandidatin demokrat për president Joe



Biden. "Ky duket të jetë një hetim antikushetues, pabaza dhe i paligjshëm", tha avokati i Giuliani, Jon Sale, në një letër drejtuar komisionit të Zbulimit. "Kërkesa zyrtare e Kongresit për dëshmi është tejet e gjerë dhe kërkon dokumente përtej qelimit të hetimit të ligjshëm", shkruante Sale, duke shtuar se "informacionet që demokratët kërkojnë mbrohen nga e drejta ligjore për të ruajtur konfidencialitetin e komunikimeve mes një avokati dhe klientit të tij".

Të martën vonë ligjvënësi Michael McCaul, udhëheqësi i republikanëve në komisionin për Çështjet e Jashtme në Dhomën e Përfaqësuesve kritikoi faktin që hetimi po zhvillohet me dyer të mbyllura në një kohë kur sipas tij, duhet të ishte i hapur për publikun.

Por Schiff tha se republikanët

janë tërësisht të përfaqësuar në seancat me dyer të mbyllura dhe se atyre u është dhënë çdo mundësi të marrin në pyetje dëshmitarët e t'i shohin provat. Seancat dëgjimore vazhduan të mërkurën me dëshminë e Michael McKinley, një ish-këshilltar i lartë i sekretarit të Shtetit Mike Pompeo.

Shtëpia e Bardhë ka kundërshtuar bashkëpunimin me hetimin dhe ka kritikuar faktin e mungesës së një votimi në Dhomën e Përfaqësuesve që duhet të kishte vendosur nëse duhet të niste ose jo hetimi për ngritjen e akuzave për shkarkimin e presidentit.

Por kryetarja e Dhomës së Përfaqësuesve Nancy Pelosi ripërsëriti të martën se një votim i tillë nuk është i nevojshëm. Ajo tha se Dhoma po respekton përgjegjësitë e saj kushtetuese.

Demokratët të cilët po hetojnë Trumpin dhe disa zyrtarë të Shtëpisë së Bardhë, dyshojnë se Giuliani drejton një politikë të jashtme në hije larg në emër të Trumpit dhe duke shmangur Departamentin e Shtetit.

Ish-këshilltari për Sigurinë Kombëtare John Bolton e ka quajtur Giuliani "një bombë me sahat që do t'i hedhë të gjithë në erë", sipas dëshmisë në Kongres të ish-këshilltares së Shtëpisë së Bardhë Fiona Hill.

Hetimet për shkarkimin e presidentit u nxitën nga ankimi i një informatori rreth përmbytjes së një bisede telefonike mes Trumpit dhe homologut të tij të Ukrainës, të cilën ai e vlerësoi si shqetësuese. Por presidenti Trump e ka cilësuar perfekt telefonatën e tij me Zelenskiy dhe ka akuzuar demokratët për "gjueti shtrigash".

## Kaos në Parlamentin e Hong Kongut

HONG KONG, 16 TETOR - Udhëheqësja e Hong Kong-ut, Carrie Lam, është detyruar të pezullojë adresimin e saj vjetor në parlament, pasi opozita e pengoi fjalimin e saj. Ligjvënësit e opozitës e ndërprejnë seancën e Këshillit Legjislativ duke bërë titur dhe ngritur parulla kundër saj. Më pas Lam e bëri adresimin përmes një video incizimi. Ndërprerja e seancës e pamundësoi edhe tërheqjen zyrtare të pro-

jektligjit për ekstradim, që ka qenë arsye e trazirave dhe protestave të dhunshme në Hong Kong, për muaj të tërë.

Projektligji është pezulluar, por mbledhja e Këshillit Legjislativ ishte mundësia e parë për të tërhequr projektligjin edhe zyrtarisht.

Protestuesit në Hong Kong për muaj të tërë e kanë kundërshtuar projektligjin, pasi ai mundësonte ekstradimin në territorin kinez.

Protestat më pas janë zgjeruar me kërkesat për më shumë demokraci dhe fushatë kundër Kinës, pasi, sipas protestuesve, Pekini po e rrit gjithnjë e më shumë ndërhyrjen në autonominë e Hong Kongut.

Mbi 1 750 njerëz janë ndaluar deri më tani si rezultat i protestave. Hong Kongu është pjesë e Kinës që nga viti 1997, por ka organizimin e vet të ligjit dhe qeverisjes, i njohur si "një shtet, dy sisteme".







## AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla  
"RITMO - L"  
Prishtinë**

**Eksperiencia jonë  
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:  
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

**Tel / kontakt:**

**044 248 173**

**044 200 604**

**044 375 333**



E rrallë

## "Kisha e Kockave" ndalon fotografitë

"Kisha e Kockave" në qytetin Kutna Hora të Çekisë është kthyer në një vend ideal për të bërë fotografi. Vetëm 60 kilometra larg Pragës, objekti i kultit, i njohur si "Kisha e Kockave", tërheq vizitorë të panumërt për shkak të dekorimit të pazakontë. Kockat e rreth 60 mijë skeleteve që janë zbuluar në zonën pranë kishës janë përdorur për ta dekoruar ndërtesën, kryesisht abazhurin e madh. 500 mijë veta hynë në kishë vetëm në vitin 2017 dhe numri



pritet të rritet. Por shumë prej turistëve përpiqen t'i lëvizin kockat nga muret, t'i prekin, t'i puthin, t'u vendosin syza dielli e kapela vetëm për fotografi. Për këtë arsye fotografitë do të jenë të ndaluara.

## FOTO E DITES



Një njeri në Vietnam shihet duke transportuar copëza plastike të mbeturinave për riciklimin. /AP/

## E jashtëzakonshme

# Qytetërim alienësh në mes të Danimarkës? Pamjet e rralla fiksojnë rrjetin

Ajo çka duket si një qytetërim alienësh në të vërtetë është një qytet-kopsht në planetin tokë. Imazhet e mahnitshme të realizuara përmes një droni na zbulojnë periferinë e çuditshme të Danimarkës, në Brøndby, Kopenhagën. Kopshtet,



shtëpitë dhe gjithçka tjetër janë në një harmoni dhe rregull të frikshëm. Koncepti i një qyteze të tillë u dha nga arkitekti Erik Mygind në vitin 1964, i cili synonte nxitjen e bashkëveprimit shoqëror në fshat.

## BARSOLETA E DITËS



Gjykatësi e vet të pandehurin:  
Çfarë profesioni ke?  
I pandehuri: Jam analfabet!  
Gjykatësi: Mirë, thuaje alfabetin.



## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

### Çdo ditë në ora 16:00 Toy Story 4 / 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi;  
1 orë 40 min

**Rolet:** Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Madeleine McGraw (Bonnie), Christina Hendricks (Gabby Gabby), Don Rickles (Mr. Potato Head), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.

Regjia: Josh Cooley



Në ora 18:00 dhe 20:00

### AD ASTRA

Aventurë/Dramë/Mister; 2 orë 04 min

**Rolet:** Brad Pitt, Tommy Lee Jones, Ruth Negga, Liv Tyler, and Donald Sutherland

Regjia: James Gray



Çdo ditë në ora 22:00


### DOWNTON ABBEY

Dramë; 2 orë 02 min

**Rolet:** Hugh Bonneville, Jim Carter, Michelle Dockery, Elizabeth McGovern, Maggie Smith, Imelda Staunton, Penelope Wilton, etj.

Regjia: Michael Engler

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), fb: Kino ABC.




#### DASHI

Kjo do të jetë një ditë mjaft intensive. Në fund do të ndjeni lodhje, por rezultatet do të jenë të mira.



#### DEMI

Sot është e rëndësishme që t'i ndërmerrni vendimet tuaja dhe t'i mbronni ato.



#### BINJAKËT

Ju jeni një ëndërrimtar, të gjithë ju duan për këtë, por sot aspektet planetare kërkojnë praktikë.



#### GAFORRJA

Nëse ju dhe bashkëshorti juaj nuk jeni ndjerë shumë të lumtur gjatë këtyre ditëve, sot ju do të keni argëtim të çmendur.



#### LUANI

Ju jeni një ëndërrimtar, të gjithë ju duan për këtë, por sot aspektet planetare kërkojnë praktikë.



#### VIRGJËRËSHA

Shumë gjëra kanë ndodhur kohët e fundit në jetën tuaj.



#### PESHORJA

Keni bërë përparim gjatë këtyre javëve të fundit, veçanërisht në ato fusha të cilat ju kanë shqetësuar.



#### AKREPI

Familja dhe miqtë mund të duken të ngadalte ndaj një kërkese që keni pasur ndaj tyre.



#### SHIGJETARI

Kjo nuk është koha më e gëzuar sepse çështjet e rëndësishme ende nuk kanë marrë rrugën e zgjidhjes.



#### BRICJAPI

Mos u përpiqni që t'i bëni gjërat me detyrim.



#### UJORI

Jeni tepër produktiv, me aftësi të fortë biznesi. Kohët e fundit mund të jeni ndier të pakënaqur me atë se ku ndodheni në jetë.



#### PESHQIT

Keni një mendje të mprehtë analitike që ju ka shërbyer mirë në biznes.





## Miranda Kerr bëhet nënë për herë të tretë


"Jemi të lumtur për ardhjen në jetë të Mylesit dhe falënderojmë të gjithë për fjalët e bukura dhe urimet në këtë çast të veçantë të jetës sonë". Kështu ka njoftuar modeluesja australiane, ish-engjëlli i 'Victoria's Secret', Miranda Kerr, 36 vjeç, e cila ka njoftuar ardhjen në jetë të fëmijës së saj të tretë. Ajo ka publikuar në rrjetet sociale një detaj të kopertinës kushtuar të voglit Myles, që e ka me bashkëshortin 29-vjeçar Evan Spiegel.

## Bella Hadidi shpallet femra më e bukur në botë



**B**ella Hadidi kryeson në listën e femrave më të bukura në botë. Ajo ka arritur të lërë pas emra të njohur të ekranit si motra e saj Gigi Hadid, Beyonce, Cara Delevigne dhe Katy Perry. Një kirurge estetike e ka shpallur Bellën

si femrën më të bukur në botë, pasi çdo gjë në fytyrën e saj ka përmasat e përkryera. Pasi bëri matjet e fytyrave të disa vajzave të njohura, rezultoi se Bella Hadidi ka një imazh që i afrohet 95 për qind fytyrës së përkryer.



## Jennifer Anistoni i bashkohet 'Instagram'-it

**C**ourteney Cox ka mirëpritur Jennifer Anistonin në rrjetin social "Instagram". 55-vjeçarja ka postuar një fotografi bashkë me një mesazh për

shoqen e saj, pasi ka hapur llogari në rrjetin më të përdorur social. "Përshëndetje Jen. Mirëserdhe në botën e rrjeteve sociale! Ta shpifë. Do ta duash", ka shkruar ajo.

## Victoria Beckham zbulon sekretin e martesës 20-vjeçare me David Beckhamin

**K**anë kaluar dy dekada qëkur Victoria dhe David Beckham i thanë 'po' njëri-tjetrit. Dhe stilistja në një emision amerikan zbuloi sekretin e martesës së tyre që i ka rezistuar kohës. "Unë mendoj se fëmijët janë përparësia jonë dhe gjithçka që bëjmë sillet rreth fëmijëve", ka thënë ajo për moderatoren Hoda Kotb. "Ne të dy punojmë vërtet shumë. E duam atë që bëjmë profesionalisht, mbësht-



esim njëri-tjetrit. Ne jemi shumë me fat që kemi njëri-tjetrin dhe jemi me fat që u rritëm së bashku", ka thënë Victoria. Duke u kthyer pas në kohë, ylli i modës kujtoi momentin ku u takua me Davidin 20 vjet më parë. "Ishte dashuri me shikim të parë", ka deklaruar Victoria Beckham.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

## Limani 'kërcënon' Ballkanin: Drita të dielën merr pozitën e parë

Një prej ndeshjeve më interesante në këtë edicion të Superligës zhvillohet të dielën në mes të Dritës dhe Ballkanit. Ardian Limani ka paralajmëruar për "Epokën e re" se pas kësaj ndeshje do të ketë ndërrim pozitash në krye të tabelës. "Jemi duke u përgatitur për këtë ndeshje shumë të rëndësishme dhe synim e kemi fitoren sepse vetëm kështu mund të dalim në pozitë të parë. Ndeshja është ndaj kryesuesit të Superligës, Ballkanit, që është një skuadër shumë e fortë. Megjithatë, ne do ta japim maksimumin dhe besojmë se do ta mposhtim", ka thënë Limani

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

**PRISHINË, 16 TETOR** - Kapiteni i Dritës së Gjilanit, Ardian Limani, ka bërë një paralajmërim lidhur me ndeshjen derbi të javës së dhjetë në IPKO Superligë në mes të Dritës dhe Ballkanit. Ai i ka dërguar "selam" skuadrës nga Suhareka se të dielën do të pësojë humbje dhe do të largohet nga pozita e liderit të elitës. "Jemi duke u përgatitur për këtë ndeshje shumë të rëndësishme. Synim e kemi fitoren, sepse vetëm kështu mund të dalim në pozitë të parë. Ndeshja është ndaj kryesuesit të Superligës, Ballkanit, që është një skuadër shumë e fortë. Megjithatë, ne do ta japim maksimumin dhe besojmë se do ta mposhtim", ka thënë Limani për gazetën "Epoka e re". Mbrojtësi që është shndërruar në shtyllë të skuadra gjilanase ka thënë se Drita do ta arrijë synimin që ta përfaqësojnë edicionin tjetër Kosovën në garat evropiane. "Meqenëse në këtë vit do të kemi tri skuadra që do të dalin në arenën ndërkombëtare, edhe gara është bërë më e fortë. Pesë apo gjashtë ekipe janë shumë cilësore. Ne jemi të bindur se do ta përfaqësojmë

Kosovën në arenën ndërkombëtare", ka shtuar Limani. Ishte pritur që në aftin kalimtar të verës Ardian Limani të transferohet në futbollin e Shqipërisë, por ky transferim dështoi në çastet e fundit. Limani ka zbuluar arsyen e mostransferimit të tij në Shqipëri e që, sipas tij, nuk ndodhi për shkak të kushteve financiare. Limani ka shkruar edhe më larg, duke thënë se tash diferenca e tregut është ngushtuar dhe se skuadrat nga Shqipëria e kanë vështirë të marrin futbollistë nga Kosova. "Kisha oferta konkrete nga Partizani i Shqipërisë, por nuk ndodhi transferimi për të vetmin arsyeje: kushtet financiare. Mendoj se Kosova i është afuar ndjeshëm tregut të Shqipërisë, andaj e ka të vështirë që të marrë lojtarë nga këtu. Këtë e dëshmon edhe ardhja e shumë lojtarëve nga Shqipëria në Kosovë", ka deklaruar Limani, i cili në fund ka konfirmuar se edhe pas afatit kalimtar të janarit, pra në sezonin pranveror, do ta djersijë fanellën e skuadrës së Dritës. Klubi nga Gjilani i Dritës, që ishte kampion i Kosovës në edicionin 2017/2018, aktualisht pozicionohet në vendin e dytë me 18 pikë, kurse Ballkani është në vendin e parë me 20 pikë.

### SHKURT

#### Çekia, vetëm 627 bileta për Kosovën

Federata e Futbollit e Çekisë ka publikuar procedurat e blerjes së biletave para ndeshjes ndaj Përfaqësueses së Kosovës që zhvillohet më 14 nëntor në qytetin e Pzlenit. Federata Çeke e Futbollit ka publikuar detajet rreth biletave për mysafirët dhe blerjen e tyre. Sipas tyre, vetëm 627 bileta do t'u takojnë tifozëve Dardanë, ndërsa blerja e biletave do të fillojë nga data 17 tetor. "Të gjithë të interesuarit këto bileta mund t'i sigurojnë nëpërmjet Federatës së Futbollit të Kosovës. Janë 627 bileta që do t'u takojnë në cilësinë e tifozëve mysafirë", thuhet në njoftimin e Federatës çeke.

#### Xhudistët kërkojnë medalje në 'Marrakech 2019'

Tre xhudistët tanë: Flaka Loxha (-57 kg), Laura Fazliu (-63 kg) dhe Shpat Zekaj (-100 kg) do ta përfaqësojnë Kosovën në Kampionatin Botëror të Juniorëve që ka filluar të mërkurën në Marrakech të Marokut. Flaka dhe Laura garojnë sot (e enjte), ndërsa Shpati të shtunën. Flaka dhe Laura vijnë pas medaljeve të bronzta të fituara në evropianin e juniorëve.

#### Maxhuni, gjyqtar në ndeshjen mes dy skuadrave turke

Gjyqtari i FIBA-s, Dardan Maxhuni, ka pranuar nominim e parë në FIBA Women Euro Cup për edicionin 2019-2020, ndeshje që zhvillohet ndërmjet dy skuadrave turke Bellona Kayseri-Orman Genclik. Kjo do të jetë hera e parë

për të që gjykon një ndeshje të nivelit të tillë. Ndeshja do të zhvillohet më 30 tetor në Turqi. Kjo vjen falë punës së madhe të FBK-së me gjyqtarët vendorë e që është duke u vlerësuar shumë lart nga FIBA Referee Department. Gjithashtu, nga Kosova në garat ndërkombëtare të FIBA-s do të gjykojnë edhe Xhelal Mumini, Daut Mehmeti dhe Elion Obërtinca.

#### Fitore bindëse nga Bashkimi

Bashkimi në konkurrencën e femrave e ka nisur me fitore edicionin e ri në Superligën e femrave. Vashat prizrenase kanë fituar ndaj Trepçës me rezultat 94:36 (22:16, 31:9, 21:5, 20:6). Ndeshja ka qenë interesante në çerekun e parë, derisa më pas fillon shpëputja e Bashkimit. Saranda Daci u dallua me 22 pikë për Bashkimin, derisa ajo u ndihmua nga Gresa Gashi me 16 pikë, Brown Khadija me 15 pikë, shtatë kërcime e pesë asistime, si dhe Aulona Muhadri me nëntë pikë e 15 kërcime. Te Trepça më e mira ishte Melisa Ibrahimimi me 17 pikë.



## La Liga kërkon që 'El Clasico' të zhvendoset në 'Santiago Bernabeu'

MADRID, 16 TETOR - Skuadra e Barcelonës është planifikuar ta presë Real Madridin të shtunën më 26 tetor në "El Clasicon" e parë të sezonit, megjithatë La Liga tani i ka bërë një kërkesë RFEF (Federatës Spanjolle të

Futbollit) që ta kalojë ndeshjen në "Santiago Bernabeu". Protestat kanë shpërthyer në Barcelonë që nga gjykimi për disa të burgosur politikë në lidhje me çështjen e pavarësisë së Katalunasve. Te drejtuesit e

La Ligas tani ka frikë se ndeshja nuk është e sigurt për t'u mbajtur në "Camp Nou". Burime të forcave lokale të sigurisë dhe Real Madridit thuhet se janë të shqetësuar se ata do të kapen në protesta. "Los

Blancos" kishte planifikuar të udhëtonte një ditë para ndeshjes dhe të flinte në Barcelonë në atë mbrëmje, megjithatë kishte frikë se protestuesit do t'i shihnin ata si një objektiv të mundshëm për t'i sulmuar.



## Messi pasi fitoi 'Këpucën e Artë': Ne jemi Barça dhe gjithmonë synojmë të gjithë trofetë

BARCELONË, 16 TETOR - Leo Messi mori të gjashtën "Këpucë të Artë" në karrierë, një çmim që e vlerëson argentinianin si golashënuesin më të mirë evropian në sezonin e kaluar. Dhënia e trofeut u organizua në Barcelonë, ndërsa kapiteni i katalanasve shoqërohej nga bashkëshortja Antonela, dy fëmijët e tij, Thiago dhe Mateo, si dhe dy shokët e skuadrës, Luis Suarez dhe Jordi Alba. I pranishëm ishte edhe një delegacion i Barcelonës, i kryesuar nga presidenti Josep Maria Bartomeu. "Pa dyshim se Liga e Kampionëve është diçka e veçantë dhe çdo vit duam ta fitojmë atë, por jemi të vetëdijshëm se La Liga është gjëja më e rëndësishme. Ne gjithmonë e synojmë Ligën e Kampionëve, por kurrë nuk harrojmë La Ligan dhe Kupën e Mbretit, sepse jemi Barça dhe duam të fitojmë gjithçka. Dua t'i falënderoj ata që janë këtu, familjen time, kolegët e mi, bordin e klubit. Gjithmonë e them se pa shokët e mi të skuadrës kurrë nuk do të isha bërë i tillë. Ky çmim iu përket të gjithëve te Barcelona. Deri herën tjetër", ka



thënë Messi. Kapiteni Blaugrana komentoi edhe pyetjet e disa fëmijëve të pranishëm: "Unë nuk jam shumë i ndërlukuar në shtëpi. Nuk bëj punë në shtëpi, gjithmonë kërkoj ndihmë për diçka". Ai, gjithashtu, zbuloi se ka një gjumë të rëndë: "Merrem shumë me jastëkun derisa të më zërë gjumi, pastaj edhe po të kalojë një kamion pranë meje dhe nuk ndiej asgjë". Një pyetje tjetër e fëmijëve kishte

të bënte me ushqimin: "Unë i kushtoj shumë rëndësi ushqimit dhe pushimit. Gjithmonë iu them fëmijëve të mi se është e rëndësishme të hanë mirë që të kenë forcë në shkollë. Ata kanë probleme të hanë perime, por ua bëj të qartë: ju duhen shumë për shëndetin". Lidhur me veshjen, Leo shtoi: "Varet nga dita, nga mënyra se si ngrihem, por jam më rehat kur rri me tuta, sportiv. Kostumin e vesh për rastet më të veçanta".

## Mick Schumacher: Jam gati të debutoj në Formula 1

VUFFLENS-LE-CHATEAU, 16 TETOR - 20-vjeçari Mick Schumacher është djali i shtatë herë kampionit të botës në Formula 1, legjendarit Michael Schumacher. Në një intervistë për "Auto Week", piloti i ri gjerman u shpreh se është gati të debutojë në Formula 1. Aktualisht Mick garon me makinën Prema në Formula 2, ndërkohë që është edhe pjesë e Akademisë Ferrari. "Të garoj në Formula 1 ka qenë gjithnjë ëndrra ime dhe kjo është ajo që dua të bëj në të ardhmen. Ndhim gati, ashtu sikurse të gjithë pilotët e tjerë, që ashtu si unë garojnë në Formula 2. Pjesëmarrja në këtë kategori të ndihmon shumë, të mëson se si t'i menaxhosh gomat e mjaft gjëra të tjera", u shpreh Schumacheri. Gjithsesi, piloti i ri gjerman shprehet se ka një kusht të rëndësishëm për t'u ngjitur në kategorinë më të lartë të automo-



bilizmit: "Nëse do të vijë rasti i duhur do ta pranoj me vrap. Më mirë preferoj të garoj edhe një vit tjetër në Formula 2 sesa të jem

pilot rezervë në ndonjë skuadër të Formulës 1. Dua të garoj dhe mësoj, jo të shoh", ka shtuar Mick Schumacheri.

### SHKURT

#### Adam: Shaqiri mund të luajë në formacionin e parë

Legjenda e Liverpoolit, Charlie Adam, ka thënë se Xherdan Shaqiri mund të luajë në formacionin e parë. Shaqiri këtë sezon nuk ka arritur të luajë në formacionin e parë, gjë që ka bërë që të jetë i zemëruar me këtë fakt. Mirëpo, Adam ka kërkuar nga lojtari të jetë i duruar, pasi mund të ketë vend të rëndësishëm në skuadër. "Mendoj se varet nga ai. Ka pasur disa lëndime në përgatitjet parasezonale. Në Liverpool të duhen lojtarët më të mirë. Ata që nuk luajnë duhet ta tregojnë vetën. Loja e tij është e mirë. Ka talent, gjithmonë e ka pasur. Fatmirësisht, mund ta tregojë vetën në Liverpool, por është vështirë në klub të tillë. Është mjaftueshëm i mirë për të krijuar raste dhe të shënojë gola. Mund t'i ndihmojë klubit ta fitojë kampionatin anglez", ka thënë Adam.

#### Reali, ofertë interesante për Kanten

Real Madridi pas Eden Hazardit po planifikon edhe një transferim nga Chelsea. Fjala është për mesfushorin N'Golo Kante, për të cilin skuadra e Realit është gati të ofrojë rreth 80 milionë euro dhe kartonin e James Rodriguezit. Në anën tjetër drejtuesit e Chelseat kanë shfaqur interesim për Jamesin, i cili ishte i huazuar për dy vjet në skuadrën e Bayern Munchenit. Pritet të shihet në janar se çfarë do të ndodhë rreth kësaj marrëveshjeje në mes të Real Madridit dhe Chelseat.

#### Cavani kërkohet nga Juve dhe Unitedi

Edison Cavani në fund të këtij sezoni pritët të largohet nga PSG-ja. Sulmuesit nga Uruguai i përfundon kontrata në qershor të vitit 2020 dhe mendon t'i japë fund aventurës në kryeqytetin francez. Siç raportojnë mediet angleze, për Cavanin janë dy ekiye që interesohen, Juventusit dhe Manchester Unitedit, të cilat kanë shfaqur interesim për sulmuesin. Cavani që prej vitit 2013 është pjesë e PSG-së, aty ku ka shënuar çdo sezon në mënyrë konstante. Kujtojmë se 32-vjeçari ka luajtur më parë edhe te Napoli e Palermo në Itali. Këtë sezon ai ka luajtur katër ndeshje dhe ka shënuar dy gola, pasi ka pasur një dëmtim që nuk e ka lejuar të luajë vazhdimisht.


#### Mendes: Ronaldo, më i miri në histori

Agjenti Jorde Mendes beson se sulmuesi Cristiano Ronaldo është lojtari më i mirë në histori të futbollit. Ronaldo arriti ta shënojë golin e 700 në karrierë në humbjen ndaj Ukrainës (2-1). "Është më i miri në historinë e futbollit dhe arritjet e tij nuk kanë përfunduar. Numrat që ka arritur nuk gënjejnë. Ka arritur gjëra të shumta në Angli, Spanjë dhe tani në Itali, gjithashtu me kombëtaren e Portugalisë", ka thënë Mendes.

#### Allegri, afër Unitedit


Ish-trajneri i Juventusit, Massimiliano Allegri, është afër të bëhet trajner i Manchester Unitedit. Ole Gunnar Solskjaer ka zhgënjyer të gjithë në sezonin 2019/20 duke qenë në vendin e 12 në tabelë. Allegri është pa klub pasi u largua nga Torino dhe do t'i bashkohet gjigantit anglez nëse plotësohen kërkesat. Sipas disa medieve, edhe Tottenhami është duke shfaqur interesim për teknikun italian. Sipas disa spekulimeve, Allegri ka kërkuar t'i ofrohet stoli brenda disa javësh pasi i duhet kohë për ta ndryshuar klubin.





REPUBLIKA E KOSOVËS  
MINISTRI E SËNDËTIT  
SHËRBIMI SPITALOR DHE UNIVERSITAR I KOSOVËS  
PROFESIONAL MENTAL HEALTH SERVICE  
PRIZREN

No. ifaqve: 2  
Data: 17.10.2019  
No. i referencës: QSHM-SHIB-17/12/19  
PRIZREN



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada-Government

**Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës**  
Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova-Hospital and University Clinical Service of Kosovo  
**Qendra e Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim në Bashkësi -Prizren**  
Community based Mental Health Centre and Houses for Integration-Prizren  
Centar mentalnog zdravlja sa domovima za integrisanje u zajednici-Prizren

Në bazë të nenit 8 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të punës Nr. 03/L-212, nenit 4, të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik, kërkesës për rekrutim nr. 58/01 datë: 09.10.2019, të aprovuar nga Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, Drejtori i Qendrës së Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim-Prizren shpallë:

**KONKURS PUBLIK**

**Titulli i pozitës së punës:** Infermier-e i përgjithshëm (Bachelor) ose Infermier-e i përgjithshëm  
**Njësia:** Qendra e Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim në Bashkësi-Prizren  
**Kohëzgjatja e kontratës:** Në kohë të pacaktuar me periudhë provuese 3 (tre) mujore  
**Koeficienti:** (5.40),(4.80)  
**Orari:** 40 orë në javë  
**Nr i Referencës:** QSHM-SHIB-17/12/19

**Detyrat dhe përgjegjësit:**

- Do të punojë si pjesëtar/e i/ e ekipit të kujdesit mjekësorë, në ofrimin e standardit me të lartë të kujdesit shëndetësor të përqendruar në pacientin, duke siguruar në çdo kohë kujdes të duhur dhe të sigurt për pacientët.
- Zbaton politikën integruese dhe udhëzimet organizative për standardet profesionale.
- Të zbatojë të gjitha aktivitetet profesionale specifike për profesionin dhe shërbimin ku punon.
- Të caktojë, planifikojë, zbatojë dhe vlerësojë kujdesin ndaj të sëmurit në përputhje me politikën e aprovuar.
- Merr pjesë në zhvillimin profesional / zhvilluar praktikën infermierike.
- Sipas nevojës të asistojë pacientit në mbajtje të higjienës personale, gjatë të ushqyerit, kryerjes së nevojave fiziologjike dhe aktiviteteve tjera që promovojnë shëndetin dhe mirëqenien e pacientit.
- Të kontribuojë në krijim të një mjedisi të sigurt klinik për të gjithë pacientët dhe kolegët.
- Të sigurojë komunikim të mirë gjatë dorëzimit të detyrës pas orarit të punës si dhe të ofrona të sakta për pacientët për të cilët është kujdesur gjatë orarit të tij/ saj të punës.
- Të ofron pacientëve informata të sakta dhe të qarta lidhur me kujdesin i cili u ofrohet atyre.
- Të kontribuojë në mbajtje të pastërtisë dhe higjienës në mjedisin ku punon dhe të punojë gjatë ditës në përputhje me udhëzuesit mbi kontrollin e infeksionit.
- Të administrojë terapinë e përkrahur në përputhje me politikën Institucionale.
- Të ndër marrë të gjitha masat e nevojshme për parandalim të dekubitit.
- Të përdor dhe të mirëmbajë në mënyrë të duhur dhe të sigurt të gjitha pajisjet.
- Të asistojë në hartimin e udhëzuesve procedurave të shkruara mbi punën e infermierëve.

Qendra e Shëndetit Mendor-Prizren tel: 029/623-931 029/623-760

- Të marrë pjesë në mbledhjet e ekipit sipas specifikave të shërbimit,
- Të marrë pjesë në aktivitetet e organizuara sipas programeve për njësi të caktuara me qëllim të shkëmbimit të njohurive dhe informative në mes të personelit shëndetësor.
- Të ruajë konfidencialitetin të plotë për çështjet që kanë të bëjnë me trajtimin e pacientit apo punën e institucionit, përveç në rastet kur ajo /ai autorizohet me shkrim, në përputhje me politikën Institucionale.
- Gjithnjë të veprojnë në mënyrë të tillë, që do të ndihmonë në avancimin e marrëdhënies së mira pacient - infermier/e.
- Të marrë pjesë në aktivitetet për edukimin e vazhdueshëm profesional në mënyrë që të freskojë dhe avancojë njohuritë dhe standardet e punës infermierike.
- Të kryejë edhe detyra tjera që kërkohen nga mbikëqyrësi për të siguruar efikasitetin të lartë në punë.
- Punon dhe bashkëpunon me profesionistët tjerë shëndetësor duke përdorur mekanizmin për monitorimin e rezultateve të kujdesit ndaj pacientit,
- Lehtëson koordinimin e kujdesit për të arritur rezultatet e shëndetit,
- Zbaton protokollet e praktikave infermierore të bazuara në dëshmi, gjatë ofrimit të kujdesit infermieror.
- Përdor dhe kontribuon në hulumtime që ndër lidhen me dëshmitë për siguri dhe praktikën efektive dhe efikente.

**Kushtet e kërkuara:**

- Diploma e Fakultetit të Infermierisë së Përgjithshme ose shkollës së mesme- ( kopje e vërtetuar )
- Licenca e punës -( kopje e vërtetuar )
- Letërnjoftimi -( kopje )
- Çertifikata e lindjes - ( kopje )
- Leje për vozitje (patent shoferi) – e dëshirueshme,
- Njohja e gjuhës angleze – e dëshirueshme,
- Njohja e kompjuterit (word dhe excel) – e dëshirueshme,
- Mund të sillni edhe dëshmi tjera të aftësisë, rekomandime, etj.


**Kushtet për pjesëmarrje në rekrutim:** Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin e kërkuar dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

**Afati për aplikim është 15 ditë nga dita e shpalljes publike në mjetet e informimit.**

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren, plotësohen dhe dorëzohen në Zyrën e Administratorit në Qendër të Shëndetit Mendor-Prizren


Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe ato të pakompletuara nuk do të pranohen.

Prizren, 17.10.2019




Drejtori  
Dr. Sci. Naimë Panaj

Qendra e Shëndetit Mendor-Prizren tel: 029/623-931 029/623-760



REPUBLIKA E KOSOVËS  
MINISTRI E SËNDËTIT  
SHËRBIMI SPITALOR DHE UNIVERSITAR I KOSOVËS  
PROFESIONAL MENTAL HEALTH SERVICE  
PRIZREN

No. ifaqve: 2  
Data: 17.10.2019  
No. i referencës: QSHM-SHIB-17/12/19  
PRIZREN



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada-Government

**Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës**  
Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova-Hospital and University Clinical Service of Kosovo  
**Qendra e Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim në Bashkësi -Prizren**  
Community based Mental Health Centre and Houses for Integration-Prizren  
Centar mentalnog zdravlja sa domovima za integrisanje u zajednici-Prizren

Në bazë të nenit 8, taqë 1 i 2 Zakona o radu br. 03/L-212 člana 4 Administrativnog Uputstva br 07/2017 o Regulisanju Procedura Zasnivanja Radnih Odnosa u Javnom Sektoru, zahteva za regrutovanje br. 58/01, dana: 09.10.2019, odobreno od strane Generalnog Direktora Univerzitetskog Kliničkog Centra Kosova (UBKSK), Direktor Centra za Mentalno Zdravlje sa domovima za integrisanje u Prizrenu, objavljuje:

**KONKURS**

**Naziv radnog mesta:** Opšti Medicinski tehničar-sestra (Bachelor) - jedna pozicija  
**Institucija:** Centar mentalnog zdravlja sa domovima za integrisanje u zajednici-Prizren  
**Trajanje ugovora:** Na neodređeno vreme uz probni period od 3 (tri) meseci.  
**Koeficijent:** (5.4), (4.8)  
**Raspored:** 40 sati nedeljno  
**Referentni br.** QSHM-SHIB-17/10/19

**Opis obaveza i dužnosti:**

- Da radi kao član tima za medicinske nege u pružanju najviši standard zdravstvene zaštite koja je fokusirana na pacijenta, obezbeđujući u svakom trenutku pravilnu i sigurnu negu za pacijente.
- Sprovedenje politike i smernice organizacione integracije za profesionalne standarde,
- Da sprovodi specifične profesionalne aktivnosti i usluge u struci u kojoj radi.
- Da odredi, planifikuje, implementira plan i evaluaciju brige o pacijentima u skladu sa odobrenim politikama.
- Učestvuje u profesionalnom razvoju / razvoj sestrinske prakse,
- Ako je potrebno da se pomogne pacijentu u okviru lične higijene, tokom hranjenja, izvođenja fiziološke potrebe i druge aktivnosti koje promoviju zdravlje i dobrobit pacijenta.
- Da doprinese stvaranju bezbednog kliničkog ambijenta za sve pacijente i kolege.
- Da bi se osigurala dobra komunikacija tokom primopredaje dužnosti i tačne informacije za pacijente za kojima se brine tokom njenog rada.
- Da nudi pacijentima tačne i jasne informacije o njihovom zbrinjavanju.
- Da doprinosi održavanju čistoće i higijene u radnoj okolini u skladu sa svim smernicama o kontroli infekcije.
- Da upravlja tretman propisan u skladu sa institucionalnim politikom.
- Preduzme sve neophodne mere za sprečavanje dekubitusa
- Da upotrebi i održava pravilno i sigurno sa svu opremu.
- Da asistira i pomogne u razvoju pisane procedure kojima se rukovodi u rad medicinskih sestara.
- Učestvuje u timskim sastancima u skladu sa specifikacijama službe,
- Učestvuje u aktivnostima koje organizuju pojedine programe jedinica u cilju razmene znanja i informacija

Qendra e Shëndetit Mendor-Prizren tel: 029/623-931 029/623-760

među zdravstvenim osobljem.

- Održavanje i sacuvanje konfidencialnosti koji se bave lečenju pacijenta ili rad institucije, osim ako ona / on je ovlašćen u pisanoj formi, u skladu sa institucionalne politike.
- Uvek deluje na način koji bi pomogao u promovisanju dobrih odnosa pacijenta – sestre-medicinskog tehnicara
- Učestvuje u radu kontinuiranog profesionalnog obrazovanja u cilju obnavljanja i unapređenja znanja i standarda sestrinske rada.
- obavlja i druge poslove u skladu sa nadzornikom da obezbedi visoku efikasnost na poslu.
- Obavlja posao i saraduje sa drugim zdravstvenim stručnjacima koji koriste mehanizam za praćenje ishoda brige o pacijentu,
- Olakšati koordinaciju nege za postizanje zdravstvenih ishoda,
- Implementira protokole sestrinski praksa bazirane na osnovu dokaza, tokom pružanje nege.
- Koristi i doprinosi rezultatima istraživanja u vezi sa bezbednošću dobre i efikasne prakse.

**Potrebno obrazovanje:**

- Diploma (bachelor) fakulteta Opšti Medicinski tehničar ili diploma srednje škole (overena kopija),
- Radna dozvola – licenca (overena kopija),
- Lična karta – kopija,
- Izvod iz matične knjige rođenih
- Vozačka dozvola - poželjno,
- Poznavanje engleskog jezika - poželjno.
- Poznavanje rada na kompjuteru (word i excel) - poželjno,
- Mogu se dostaviti i dodatni dokazi o osposobljavanju ili preporuke, isl...


**Uslovi učešća u zapošljavanju:** pravo da se prijave imaju svi punoletni državljani Republike Kosova koji imaju punu pravnu sposobnost. onih koji su završili svoje obrazovanje i imaju adekvatnu stručnu sposobnost za obavljanje zadatka.

**Rok za prijavu je 15 dana od datuma objavljivanja konkursa u javnim medijima**

**Podnošenje prijave:** Prijave možete uzeti, ispuniti i dostaviti u Administrativnoj Kancelariji Centra za Mentalno Zdravlje u Prizrenu.

Aplikacije podnete nakon isteka roka i nepotpune prijave neće biti prihvaćene.

Prizren, 17.10.2019



Drejtori  
Dr. Sci. Naimë Panaj

Qendra e Shëndetit Mendor-Prizren tel: 029/623-931 029/623-760



**Kërkesa për shprehje të interesit**  
Emri i shkollës: **"Ismet Uka"**  
Komuna: **Skenderaj**  
Data: **17.10.2019**

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
<b>ESIP/SDG/115-CS/1.3</b>	Trajnim Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe **Shfmu "Ismet Uka" Ticë, Skenderaj**

Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme: **Trajnim: Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie - TIK**

#### Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme.
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe personelin e shkollës
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme.

#### Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e TIK (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

#### Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).

Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën **Shfmu "Ismet Uka" Ticë, Skenderaj, më së largu deri më datën; 25.10.2019**

Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

**Detajet kontaktuese të shkollës:**  
**Personi kontaktues: Hamide Abazi**  
**Telefoni: 044/588-596**  
**E-maili: hamideabazi.86@hotmail.com**

**Kërkesa për shprehje të interesit**  
Emri i shkollës: **"Bashkim Sadiku"**  
Komuna: **Skenderaj**  
Data: **17.10.2019**

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
<b>ESIP/SDG/106-CS/1.2</b>	Trajnim: <b>Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie</b>

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe **Shfmu "Bashkim Sadiku" Skenderaj, Skenderaj**

Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

